

TAHAR BEN JELLOUN

**MARTESA PËR QEJF**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



TAHAR BEN JELLOUN

MARTESA PËR QEJF

roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht  
Nonda Varfi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Autori: Tahar Ben Jelloun (Tahar Ben Zhelun)  
Titulli në origjinal: Le mariage de plaisir  
Botoi në frëngjisht: Éditions Gallimard

Cet ouvrage a bénéficié du soutien du Programme d'aide à la publication du ministère français de l'Europe et des Affaires étrangères, ainsi que du soutien des Programmes d'aide à la publication de l'Institut français.

Ky libër është mbështetur nga Programi i Ndihmës për Botim i Ministrisë Franceze të Evropës dhe të Punëve të Jashtme, si edhe nga Programet e Ndihmës për Botim të Institutit Francez.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-44-2

© Éditions Gallimard, 2016

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Për Aminin*



“Për Allah, motra ime, na rrëfe një histori  
për ta bërë të këndshme mbrëmjen tonë.”  
“Me shumë kënaqësi - ia ktheu Shehrëzade, - në  
qoftë se ky mbret i sjellshëm dëshiron.”  
Kështu, ngaqë nuk e zinte gjumi,  
mbreti mezi priti të dëgjonte një përrallë.

“Siç rrëfejnë, Madhëri, o mbret i lumtur,  
na ishte njëherë...”

Nata 1 e *Një mijë e një net.*





## Kapitulli 1

Dikur, në qytetin e Fesit, ishte një rrëfimtar që nuk ngjante me askënd. Quhej Goha, lëkurën e kishte shumë të zeshkët, trupin e thatë dhe të fortë, shikimin e mprehtë dhe shumë dashamirës. Zbriste nga Jugu pas reshjeve të mëdha, zakonisht në fillim të pranverës, zinte vend te një shesh në hyrje të qytetit të vjetër, herë në Batha, herë në Bab Bujlud, linte sendet përtokë dhe priste që rreth tij të mblidheshin njerëzit. Me kulturë të madhe, sa arabe, aq edhe berbere, me një imagjinatë të jashtëzakonshme, i njohur për ashpërsinë e gjykimit dhe për ngurtësinë e qëndrimeve, ai kishte ithtarë dhe kundërshtarë, që prisnin gjithë vitin që të mbërrinte për të mos humbur asnjë nga historitë e tij. Ata përhapnin lajmin, “Ka ardhur!”, mbyllnin dyqanet dhe shkonin ta dëgjonin. Nuk u rrëfente vetëm histori. I pëlqente gjithashtu të përmendte situata historike për t’i futur në mendime. Gjërat nuk i thoshte troç, i binte vërdallë. Ishte, siç thoshin, mjeshtër në atë teknikën që qëndron në vendosjen e vështrimit tek e tashmja, duke mbajtur gjithmonë një këmbë në të shkuarën, që shpesh ishte

jo aq e lavdishme sa thuhej. Nuk e fshihte tërbimin për mënyrën se si Maroku i ishte dorëzuar Francës gjatë protektoratit. Thoshte me ironi: “Dhe kështu iu falëm Lalla<sup>1</sup> Francës, vendit të vjetër të Iluminizmit dhe kokave të mençura, vendit të babëzitur. Algjeria nuk i mjaftonte, madje as Tunizia, duhej të gëlltiste edhe vendin tonë! I mjeri Marok! E mjera Lalla Franca!”. Dhe, befas, në mes të fjalës, ndalonte, pinte një gllënjë ujë, merrte një fshesë dhe niste të pastronte vendin. Kur largohej, rrëfimtari gjithnjë e harronte tasin e tij të mbushur me monedha, duke ua lënë atë lypësve, të cilët, siç thoshte, kishin më tepër nevojë se ai. Policia dërgonte vazhdimisht dikë që ta dëgjonte. Por nuk kishin gjetur asnjëherë ndonjë gjë për ta qortuar: ai rrëfente histori dhe nuk prishte rendin publik. Gjatë rrëfimit, tregimtari i luante të gjitha rolet njëherësh, herë maskohej, herë merrte poza provokuese dhe, mbi të gjitha, dinte gjithnjë të tërhiqte vëmendjen e publikut. Ishte njëherësh komedian dhe poet, që, për të çoroditur dëgjuesit, gjithmonë i pëlqente ta niste me këto fjalë:

“Ju që mbani vesh historitë e mia, dëgjoni këshillën e atij që është rritur në duna dhe ka jetuar gjithmonë mbi kreshtën e pasioneve: Bëhuni të ligj! Mos nguroni: bëhuni të ligj! Në e kam gabim, më sillni në

---

<sup>1</sup> Titull honorifik që u jepet grave të rëndësishme ose atyre të familjeve të mëdha te berberët e Afrikës së Veriut. Titulli përdoret edhe në shenjë respekti (sh. p.).

binarë, ligësia juaj duhet të qëndrojë gjithnjë zgjuar. Dhe mos e ulni kurrë vigjilencën, përqafoji të Keqen, atë të Keqe që rritet brenda nesh si bimë helmuese, si algë e qelbur dhe vrasëse, që ushqen vrerin tonë dhe e shndërron atë në helm që rrjedh në ulluqet e jetës. Bëhuni të ligj, nuk e dua shpirtbutësinë tuaj. Moshë, rrudhat, dobësitë e shumta, kujtesa që shkon e vjen, mund të më tradhtojnë në çdo kohë, mund t'ju trazojnë historitë që rrëfej dhe t'ju mashtrojnë. Po u bëtë të ligj, do të jetoni gjatë! Bëhuni mizorë dhe të këqij. Të pamëshirshëm dhe të pashpirt! Po u bëtë të ligj, do të fitoni kohë!”.

    Rrëfimtari ishte njeri i urtë. E dinte se ishte e kotë t'ju kërkonte njerëzve të ishin të mirë, se mirësia nuk kishte nevojë për paterica për të ecur përpara. Një darkë, kur ishte kalimthi në Fes, i rrethuar nga një turmë e vogël, Goha vendosi të ndërronte temë dhe nisi të tregonte një histori që nuk e kishin dëgjuar kurrë:

    “Nuk bëhet hataja për një herë, sonte do t'ju tregoj një histori dashurie, një dashuri të çmendur dhe të paimagjinueshme, por të jetuar deri në grahmën e fundit nga secili prej personazheve. Por, si do ta shihni, pas kësaj historie të mrekullueshme ka edhe shumë urrejtje e përçmim, ligësi dhe mizori. Kjo është normale. Njeriu kështu është. Do të parapëlqejë ta dinit që të mos habiteshit.

“Kështu, në qytetin e Fesit, na ishte njëherë një djalë i vogël me emrin Amir, i lindur në një familje tregtarësh, të cilët thoshin se ishin pasardhës të profetit.

“Ishte dita e parë e reshjeve, vëllai i tij i vogël sapo kishte mbushur një vjeç, kur papritmas në qytet u përhapën thashetheme se lypësi ishte kthyer. Ata që e kishin takuar, rrëfenin se zëri i tij i ngjirur dhe i trashë, ishte i frikshëm; se qepallat i dridheshin disi nga nervozizmi; se mjaftonte një lëvizje dore për të bindur dikë që të mos i priste rrugën. Dhe të gjithë ishin në një mendje se ai lëshonte një erë të padurueshme, që e paraprinte dhe qëndronte shumë kohë pas largimit të tij. Askush nuk kishte guxuar deri atëherë t’i afrohej, ose t’i jepte lëmoshë. Megjithatë, fytyra e tij thoshte diçka tjetër. Veçanërisht sytë e kaltër dhe të mëdhenj lëshonin një dritë të çuditshme.

“Çfarë kërkonte lypësi, nga vinte, si e kishte emrin? Askush nuk mund ta thoshte. Por fëmijët e pagëzuan menjëherë El Ghool (përbindëshi), El Ghaddar (tradhtari) ose El Henche (gjarpëri). Të rriturit, nga ana e tyre, e quanin Ould Lehrame (bastardi), ai që lajmëron fatkeqësinë.

“Disa ditë pasi u largua, një epidemi tifoje u përhap në Fes. Vëllai i vogël i Amirit ndërroi jetë brenda disa orësh. Megjithatë, Amiri dhe prindërit ishin fatlumë që shpëtuan nga sëmundja.

“Pas disa ditësh shqetësimi, shumica e banorëve të Fesit shpëtoi. Epidemia ishte zhvendosur në male

dhe në fshatra, ku vdekja kishte aq shumë punë për të bërë. Fesi, sa hap e mbyll sytë, mori statusin e ‘qytetit të shenjtë’, pa miratimin e autoriteteve fetare.

“Por Fesi, në fshehtësi, i druhej rikthimit të lypësit, kujtimi i të cilit ishte ngulur në kujtesë. Për fat të mirë, deri atëherë lutjet në Xhaminë e Madhe dukeshin sikur e kishin sprapsur.

“Gjatë gjithë fëmijërisë së tij, me shirat e para të stinës, zëri i trashë i lypësit vazhdonte të kumbonte në veshët e Amirit dhe t’i kallte një frikë të papërshkrueshme. Duke u rritur, Amiri, më në fund, e harroi, por u bind se vdekja e kishte kursyer ngaqë duhej të përmbushte një qëllim të madh mbi këtë tokë.

“Kur mbërriti në moshë madhore, Amiri ishte bërë një burrë i pashëm, me lëkurë të bardhë, me trup mesatar, i shëndoshë, me buzë të vizatuara bukur dhe me supe pak të rëna. Ashtu si prindërit, ushtronte zanatin e tregtarit në qytetin e vjetër të Fesit, në lagjen *Divan*. Ishte njeri i mirë, optimist, pa imagjinatë, që nuk mungonte në asnjë prej pesë lutjeve të përditshme. Ishte martuar në moshë shumë të re me Lalla Fatmën, me një vajzë nga një familje e madhe e Fesit, dhe ishte baba i katër fëmijëve. Tre djem dhe një vajzë.

“Në atë kohë, Fesi vazhdonte t’i kthente shpinën botës. Kishin kaluar tashmë më shumë se dyzet vjet që Maroku ishte nën protektoratin francez dhe aristokracia e vjetër e Fesit, që zotëronte qytetin, e ruante autoritetin e saj me një qetësi të

jashtëzakonshme. Nuk interesohej fare se çfarë ndodhte jashtë Medinës. Për të, bota mbaronte atje, në ato rrugica, në ato shtëpi të vjetra, disa prej të cilave ishin pallate, duke pritur kthimin e përjetshëm të stinës së limonëve. Zejtarët merreshin me zejtari, tregtarët bënin tregti, zotërinjtë udhëtonin me kuaj në rrugica e ngushta dhe nuk e vinin në dyshim superioritetin e sërës së tyre. Për më tepër, ishin ata që, në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kishin zgjedhur sheshin e vogël e të rrumbullakët mes *Ashabinës* dhe *Shemayinës*, në fund të Medinës, për të organizuar, një të enjte në muaj, një Pazar, ku shiteshin skllevër të zinj të sjellë nga Afrika.

“Skllavëria ishte e natyrshme. Bënte kërdrinë në të gjithë botën dhe banorët e Fesit nuk ishin të prirë të ndryshonin ndonjë gjë në rendin e padrejtë të botës. Ata ishin të kënaqur që jetonin sipas traditave dhe mendonin se kishin për detyrë t’i vazhdonin dhe t’i mbronin ato. Skllevërit e parë mbërritën në Marok falë tregtisë, që banorët më të zotë të Fesit bënin me vendet afrikane më pranë tyre. Edhe pse ndanin të njëjtin kontinent, ata nuk e quanin veten afrikanë. Banorët e Fesit ishin të bardhë, pra, superiorë ndaj të zinjve, pavarësisht se nga vinin këta të fundit.

“Në Fes, në vigjilje të pavarësisë së vendit, asgjë nuk duhet të ndryshonte, asgjë nuk mund të ndryshonte. Francezët e vëzhgonin këtë nga larg. Një mbulesë e leshtë dhe e pambuktë ishte vendosur

mbi qytet. Megjithatë, atje, gjatë shekujve ishin vulosur shumë histori dhe të fshehta. Çuditërisht, nuk kishte njeri t'i tregonte, t'i zbulonte, t'i përzinte nga ajo shoqëri e kënaqur me veten, me origjinën, zakonet, me kulturën e saj që ngatërrohej me vlerat e Islamit. Shumë hebrenj dhe myslimanë të dëbuar nga Andaluzia, nga katolikja Isabela, kishin gjetur gjithsesi strehim në Fes dhe kishin siguruar pasurinë e qytetit, rinovimin dhe origjinalitetin e tij. Me gjasë, atje mund të konvertoheshe, madje pa ndryshuar as emrin. Por ajo kohë kishte marrë fund.

“Për të furnizuar tregtinë e tij me erëza dhe prodhime të rralla, Amiri shkonte çdo vit në Senegal dhe qëndronte disa muaj larg Fesit. Babai dhe gjyshi, të cilët e kishin bërë këtë tregti para tij, e kishin zakon të gjenin një grua gjatë qëndrimit të tyre atje. Amiri, të cilit i pëlqente të respektonte rregullat dhe nuk donte të qortohej po të bënte diçka të ndaluar nga feja, u këshillua për këtë çështje me Mulla Ahmadin, profesorin e madh të teologjisë në Universitetin *Al-Karauinë*, të cilin e pyeti nëse ‘martesa për qejf’, ashtu siç quhej, nuk ishte mëkat, veprim që binte ndesh me besimin dhe lëndonte të shoqen. Në të vërtetë, Amiri kishte disa skrupuj për këtë çështje.

“Mulla Ahmadi e qetësoi. Citoi vargun 24 të sures ‘Gratë’: ‘... ju lejohet ta përdorni pasurinë tuaj për t’u martuar ndershmërisht, por jo të jetoni jashtë kurore. Jeni i detyruar t’i jepni prikën e taksur asaj, me të cilën

do të martoheni...’ me fjalë të tjera, është e ligjshme që një burrë, i cili largohet nga shtëpia për një periudhë të gjatë, të lidhë një martesë ‘për qejf’, ‘kënaqësi’, ‘për t’u ndier mirë’, që i garanton gruas një prikë dhe respektin e atij, me të cilin është martuar. Perëndia e ka ligjëruar këtë për të luftuar prostitucionin.

“Është e vërtetë, komentoi Mulla Ahmadi, se martesja për qejf, e bërë jashtë vatrës familjare për një periudhë kohe, ka një aromë të ndaluar, që mund të nxisë instinktët më të ulëta të njeriut. Megjithatë, në asnjë rast, nuk duhet të kuptohet si cytje për të poshtëruar gruan legjitime të lënë në shtëpi, ose ta keqtrajtojë atë, me të cilën ju konsumoni një martesë për disa kohë. Ky nocion i ‘qejfit’ ka të bëjë me kohën e shkurtër të marrëdhënies. Martesja tjetër, e vendosur prej kohësh dhe për riprodhim, nuk e largon kënaqësinë, por e zbeh.’

“Amiri e dëgjonte mjeshtrin me shumë vëmendje:

“Ata thonë se profeti ynë i dashur do ta kishte pranuar një martesë për qejf. Por kalifi i dytë, Omar ibn al-Khattab, e ka hedhur poshtë këtë version para se të vdiste. Në fakt, kjo është një nga pikat e mosmarrëveshjes mes shiitëve, që e lejojnë, dhe sunitëve, të cilët e vënë në dyshim. Por ka pasur shumë debate mes teologëve sunitë rreth kësaj teme, dhe al-Châfi, për shembull, e ka miratuar këtë martesë nga çasti që pikësynimet e bashkëshortëve janë të qarta dhe kohëzgjatja e saj është e kufizuar. Kjo është arsyeja pse kjo praktikë vazhdon ende sot. Thelbi



qëndron në vendosjen e kufijve midis ndershmërisë dhe respektit për gruan.’

“Amiri, i qetësuar, që nga ai çast, në çdo udhëtim të tij në Afrikë, lidhi një martesë për qejf për të qenë i mbrojtur nga mëkati.

“Pas një vit qëndrimi në Fes, duke u marrë me tregti dhe duke u kujdesur për familjen, erdhi përsëri koha që Amiri të kthehej në Afrikë. Atë vit, kishte vendosur të merrte me vete Karimin, djalin e vogël. Duke u marrë me përgatitjet e udhëtimit, Amirin, kur mbërrinte në darkë, mezi e zinte gjumi. I linte mendimet të endeshin dhe të bashkoheshin me thashethemet e qytetit të Fesit të zhytur në errësi. Atje takonte shpirtin e shqetësuar të njerëzve që flinin, siluetat e grave që natën dinë aq mirë të lëvizin trupat, format e tyre që turbullojnë ëndrrat e tregtarëve dhe u japin atyre ngjyra aq të jashtëzakonshme që e bëjnë njeriun, e kapur në kthetrat e natës, të udhëtojnë...

“Një natë para nisjes, i shqetësuar më shumë se kurrë nga ëndrrat, Amiri u ngrit dhe zbriti në kopsht. Shëtiti një çast në gjysmerrësi dhe zbuloi, mes gjetheve të gjelbra të një peme palme, një lule të bardhë që kishte çelur dhe që dukej, e vetme dhe krenare, sikur lajmëronte mbërritjen e afërt të verës dhe më vonë të hurmave të vjeshtës.

“Amiri e këqyri atë mrekulli të natyrës dhe falënderoi Perëndinë që kishte lejuar një bukuri të tillë të çelte në kopshtin e tij. Soditi për një kohë të

gjatë lulen borë të bardhë dhe mendja i shkoi tek e reja peule<sup>1</sup>, të cilën e kishte takuar gjatë udhëtimeve të tij të fundit dhe që shpresonte ta takonte sërish së shpejti, larg këtij kopshti, në një vend tjetër, në një botë tjetër, në një kohë tjetër. Dhe me vete tha: ‘Sa shumë i ngjan kjo lule. Është aq e bardhë sa ç’është e zezë ajo grua e re me kundërmim qelibari dhe dru santali’”.

---

<sup>1</sup> Popull në Afrikën Perëndimore (sh. p.).

## Kapitulli 2

Kur u largua nga Fesi për në Senegal me të atin, Karimi sa kishte mbushur trembëdhjetë vjeç dhe mbante me krenari në qafë medaljen e katërt të fituar në garën e fundit të notit, ku kishte shkëlqyer. I ati, gjatë këtij udhëtimi, donte t'ia besonte për disa ditë një plaku të mençur senegalez nga Goreja, i famshëm për trajtimin e fëmijëve të lindur me aftësi të kufizuara.

Karimi nuk ishte si fëmijët e tjerë. Ishte i gjallë dhe i mençur, por i vonuar. Në atë kohë, këta fëmijë ishin pak të mbyllur, lireshin të shëtisnin dhe të ktheheshin vetëm dhe, nëse humbisnin, gjithmonë kishte njerëz që i sillnin në shtëpi.

Kur lindi Karimi, Turia, mamia, deklaroi se ai fëmijë kishte një zemër të pastër, të bardhë si mëndafshi dhe se duhet ta linin të jetonte dhe të zhvillohej me ritmin e tij. Lalla Fatma, e ëma, qante, ndërsa Amiri, babai, përpiquej t'i pranonte fjalët e mamisë.

Ai thirri një mjek francez për të vizituar Karimin. Por gjatë vizitës Amiri nuk e kuptoi se çfarë thoshte specialisti. Dëgjoji fjalë që nuk i merrte vesh,

“kromozom”, “trisomi”, “mongolizëm”. Mjeku mori një letër dhe vizatoi një degë peme nga të dyja anët, duke i shpjeguar se djali kishte diçka të tepërt që do ta vononte rritjen e tij, porse nuk ishte gjë shqetësuese, sepse ata fëmijë nuk jetonin gjatë dhe se së shpejti ai do të largohej dhe kështu familja do të shpëtonte prej tij... Para pamjes së habitur dhe mosbesuese të babait, mjeku, madje, shkoi aq larg sa propozoi t’ia besonin Karimin një shoqate në Francë, e cila do ta merrte përsipër: Amiri nuk do ta takonte kurrë, vetëm se për këtë duhej të paguante dhe çështja do të mbyllej... Francezi ishte i sigurtë, përsëriste ato që kishte mësuar dhe nuk dukej se ishte i vetëdijshëm që po lëndonte shumë një baba. Para se të largohej, ai u përkul nga Amiri dhe i pëshpëriti: “Ju e dini, edhe gjeneral De Goli ka pasur një fëmijë si i juaji, kështu që... Pak njerëz e dinë, por në ushtri ka thashetheme se kjo është e vetmja humbje e tij në jetë! Ditën kur i vdiq e bija, ai do të thoshte: ‘Tani ajo është si të tjerët.’”

Amiri falënderoi francezin, e pagoi për vizitën dhe u kthye tek e shoqja, e cila vazhdonte ende të qante. Mamia, që kishte marrë pjesë në vizitë, përpiquej t’i qetësonte të gjithë. Duke menduar se vetëm Amiri ishte në gjendje ta dëgjonte, ajo u përpoq ta ngushëllonte:

- Ky fëmijë është fat, është shenjë e Perëndisë, një e mirë që Perëndia të ka dërguar. Këta fëmijë, ndryshe

nga të gjithë të tjerët, nuk e njohin fare të keqen, nuk dalin dot nga rruga e drejtë. Ne duhet t'i duam, sepse ata kanë një dashuri të pafundme. Nuk mund t'i flakim, as t'i fshehim. Unë kam njohur disa prej tyre që jetojnë ende dhe që, në moshë madhore, shumë njerëz u shkojnë për vizitë, sikur të ishin shenjtorë apo engjëj. Ky fëmijë është dritë, do ta shihni, do t'jua ndriçojë jetën.

Si besimtar i mirë, Amiri e pranoi fatin dhe me vete tha:

“Në qoftë se Perëndia e lindi këtë fëmijë, kjo sepse ka arsyet e tij, kush jam unë që të kundërshtoj vullnetin hyjnor? Ky fëmijë ka pasurinë e tij, do të ketë jetën e tij dhe unë do ta shoqëroj derisa të kem frymë. Perëndia është i madh. Unë e di çfarë ka thënë profeti ynë: ‘Besimtari është i përgatitur për të duruar mjerimin dhe provën.’”.

Lalla Fatma nuk fliste, shikonte tavanin dhe nuk pranonte ta mëkonte foshnjën. Për herë të parë pas martesë, Amiri i foli asaj me ton të ashpër. Ajo duhej ta pranonte realitetin. Fjalët e ashpra që shqiptoi, fillimisht e shkundën dhe e bënë të qante edhe më shumë. Pastaj, pasi heshti pak, ajo shtriu krahët për të marrë foshnjën dhe i dha gji.

Që atëherë, Karimi kishte një vend të veçantë në familje. Rritej me pekule. Sa herë që mbërrinte një mjek i ri në Fes, Amiri e takonte për të mësuar nëse gjendja e djalit të tij do të ndryshonte një ditë. Por e

kuptoi se ai fëmijë kishte nevojë vetëm për një gjë: për dashuri. Dashuria e bënte të ndihej mirë dhe i lumtur.

Për dymbëdhjetëvjetorin e lindjes, i ati i bëri atij një premtim:

“Herën tjetër kur të shkoj në Senegal, do të të marr me vete!”.

Tepër i gëzuar, Karimi shkoi me vrap te pianoja e vjetër, e çakorduar, dhe luajti një melodi për të shprehur lumturinë. Vëllezërit dhe motra nuk kishin çfarë të thoshin. Nuk diskutoheshin vendimet e babait. E kërkonte zakoni. Zëri nuk ngrihet kur u drejtohem prindërve; u puthim duart dhe supin, ulim sytë kur flasim. Kështu ishte.

Disa muaj më vonë, në fillim të dimrit, Amiri i kërkoi gruas të bënte gati plaçkat e tij dhe të Karimit. Ata u larguan nga shtëpia në mes të natës, përshkuan Fesin e shkretë, çka i jepte largimit të tyre një ndjesi magjike dhe joreale.

Udhëtimi me tren, me karrocë dhe mbi deve zgjati më shumë se dy javë. Koha ishte e bukur dhe ndalesat mjaft të shpeshta. Amiri, pas lutjes së mbrëmjes, përfitoi nga rasti për t’i përcjellë ato që kishte mësuar për atë kontinent dhe banorët e tij. I tha: “E di që nuk kam nevojë të të paralajmëroj, ti je djalë i mirë dhe i zgjuar. Në këtë vend, mbi të gjitha, duhet të tregosh respekt! Nëse do që të të trajtojnë mirë dhe me konsideratë, fillo ti i pari të sillesh në mënyrë të

paqortueshme. Trego respekt dhe bujari. Njerëzit janë shumë të ndjeshëm dhe do të ta kthejnë njëqindfish atë që ti do t'u japësh. Janë poshtëruar dhe përçmuar aq shumë nga kolonialistët e bardhë, francezë dhe belgë, sa janë dyshues ndaj të gjithë lëkurëbardhëve. Por mos harro se edhe ne jemi afrikanë. Nuk jemi të zinj, por i përkasim këtij kontinenti dhe këtyre popujve. Pra, kujtohu se profeti ynë i dashur e liroi nga skllavëria Bial Ibn Rabah-un, skllavin e zi me zë të bukur. Muhamedi e kishte emëruar myezin të parë të Islamit. Për fat të keq, skllavëria ende është një traditë për ata që ndihen më superiorë. Do ta shohësh, do të na presin shumë miqësisht. Pra, të tregohemi të denjë ndaj kësaj mirëpritjeje!”. Pastaj, sikur të rivendoste ekuilibrin, shtoi: “Por mos mendo se të gjithë janë aq të mirë sa ti; të ligj ka kudo, ki kujdes kur je vetëm”.

Karimi e dëgjonte Amirin me vëmendje. E vlerësonte shumë bekimin e të atit. Nuk bëhej fjalë të rebelohej apo të kundërshtonte fjalët e tij. Amiri thoshte për t'u justifikuar: “Kurani na këshillon të kemi respekt absolut për babanë dhe nënën, si edhe për ata që na mësojnë njohuritë e tyre, mësuesit, filozofët, dijetarët apo edhe mësuesin e thjeshtë të shkollës”. Dhe shtonte: “Asnjë arritje në jetë nuk është e mundur pa këtë bekim; respekti është shenjë e përlësisë, mënyra më e mirë për të mësuar dhe për të ecur përpara”. Karimi i kuptonte shumë mirë të gjitha çka i thoshte i ati. Kishte një zgjuarsiri të

veçantë, por e kishte të vështirë të përgjigjej, madje më tepër për t'i shpalosur mendimet e tij. Ndoshte që nevríkosej dhe skuqej i tëri sepse fjalët nuk dilnin ose mbërrinin të gjymtuara, copa-copa. Ai përsëriste të njëjtin tingull, belbëzonte, sikur i përgjërohej një force të brendshme për ta ndihmuar të fliste. Amiri, që në fillim, vendosi ta trajtonte atë si fëmijë normal, duke pranuar ekzistencën e aftësive e tij të kufizuara që duhej t'i mbante parasysht në situata të caktuara. Me gjithë ndërhyrjet e Amirit, Lalla Fatma e kishte të vështirë me këtë fëmijë dhe parapëlqente të kujdesej për tre fëmijët e tjerët. Por Karimi ishte shumë i dashur me nënën e tij. Kur i thoshte asaj me fjalë të ngathëta sa shumë e donte, ajo qante. Në vend që të gëzohej, kthente kokën dhe kërkonte një shami për të fshirë lotët. Një ditë, ai i tha: “Edhe unë, unë... unë... qaj...”.

Karvanari ishte një saharian fjalëpakë. Me lëkurën e regjur nga dielli, me trupin e thatë, ai vazhdonte përpara tepër i sigurt. Mbante në sup një pushkë të vjetër dhe një kamë te beli. Ishte koha kur udhëtarët sulmoheshin. Ai i njihte shtigjet për t'u shmangur dhe për t'i çuar klientët e tij shëndoshë e mirë. Për atë, shkretëtira nuk kishte të fshehta. Për shkak të kësaj, udhëtimi zgjati një ose dy ditë më tepër. As Karimi, as i ati, nuk e kishin me ngut dhe nuk e bezdisnin udhërrëfyesin, që ishte edhe kuzhinier i mirë. Ky e



dinte se banorët e Fesit ishin të brishtë, të mësuar me gjellë të sqimëta, as shumë pikante, as tepër të yndyrshme. Ai u gatuante kropa të mbushur me copa mishi, me reçel, me vezë të ziera fort dhe me qimnon. Vakti mbyllej me disa hurma. Ndonjëherë u jepte për të pirë qumësht deveje, por e vinte re se ata mezi gëlltiteshin. Preferonin çaj jeshil me nenexhik. Ai i hidhte çajit shumë sheqer kështu që Amiri dhe djali i tij kërkonin shpesh ujë të nxehtë për ta zbutur. Kjo e bënte për të qeshur.

Sahariani kishte qenë dikur luftëtar. Kishte luftuar kundër ushtrisë spanjolle, e cila, në vitin 1934, ishte vendosur në krahinat jugore të Marokut, duke përfshirë edhe Sidi Ifnin, qytetin e tij të lindjes. Vendi ishte nën protektoratin francez, por një pjesë e tij ishte pushtuar nga Spanja e udhëhequr nga një gjeneral me emrin Franko.

Një mbrëmje, ai u rrëfeu atyre një episod nga kjo luftë antikoloniale: “Spanjollët ishin të pacipë; silleshin si banditë dhe mendonin se vendasit ishin kafshë. Ata ishin ushtarakë të rëndomtë, na përbuznin, flitej se ishin të dënuar dhe ishin dërguar në shkretëtirë, për të cilën nuk dinin asgjë. Pinin alkool dhe silleshin pa respekt ndaj familjeve tona. Një ditë, babai i një vajze të rrëmbyer nga një grup ushtarësh të dehur mbërtheu një thikë të madhe dhe ia nguli në qafë një nënoficeri. Atë e vranë në vend. Varrimi i tij ditën tjetër ishte një mundësi për të shprehur zemërimin tonë. Ushtria qëllloi mbi ne. Pati tre të vdekur dhe pesë të plagosur.

Që nga ai çast, rezistenca u organizua spontanisht. Ushtria e dinte se ne nuk e pranonim atë pushtim. Ishim të paktë në numër, por të matur; sabotonim ato që ushtarët përpiqeshin të ndërtonin. Kishte urrejtje të thellë në të dyja anët, vetëm se ne ishim në anën e ligjit dhe të drejtësisë. Përse ata ushtarë të veshur me lecka kishin ardhur për të pushtuar territorin tonë? Ua bëmë jetën zgjyrë. Një ditë ata do të largohen përfundimisht dhe shpresoj se nuk do të shkulin kurrë në vendin tonë”.

Një natë, ndërkohë që përgatiteshin për të fjetur, Karimi kërceu përpjetë dhe tha:

- Lua! Unë... pashë një luan...

Karvanari ishte i prerë:

- Këtu, s’ka luan.

Karimi këmbëngulte, por udhërrëfyesi nuk ia varte. Babai ishte i shqetësuar sepse e dinte që Karimi nuk fliste kurrë kot, se nuk bënte shaka. I kërkoi udhërrëfyesit të shkonte ta verifikonte. Ai nuk kundërshtoi. Disa minuta më vonë, udhërrëfyesi u shfaq i frikësuar, duke pohuar se me të vërtetë ishte një luan, që ishte larguar. Tundi pushkën e tij të vjetër:

- Tani e tutje, unë do të besoj gjithçka që do të më thotë Karimi!

Gjumi ishte i shkurtër dhe mbi të gjitha i shqetësuar. U nisën për rrugë në mes të natës, të lodhur dhe të heshtur. Një çast, Amiri pyeti djalin nëse shikonte diçka të rrezikshme, ose dëgjonte zhurma shqetësuese. Karimi, gjysmë i përgjumur, u përgjigj:

- Jo, jo, asgjë... Vetëm një piano... e shoh, unë...  
dëgjoj... vajzë pi... piano...

Karimi i binte pianos pa marrë mësim. I binte pianos dhe jo dosido. E kishte dhunti. Gjatë udhëtimit në shkretëtirë, disa melodi i vinin në mendje. Muzika i mungonte.

Karvanari u habit:

- Pas luanit, piano!

Karimi vuri gishtin te tëmthat dhe tha:

- Është këtu brenda!

- Dëgjon muzikë?

- Po, buk... mu... zikë bukur.

- Je me fat.

Karimi dëgjonte kështu me mendje një koncert. Dukej tërësisht i përqendruar. Papritur, u ndal dhe tha:

- Pi... piano duhet të bëjë çifin!

U largua nga karvani dhe urinoi duke qeshur.

Ata mbërritën një mëngjes herët në Ndar, i quajtur gjithashtu Sen-Lui, qyteti i parë i themeluar nga europianët në Afrikën Perëndimore. Qielli ishte i bardhë dhe ajri i lagësht. Kjo e bëri Karimin të thotë: “Duket sikur jemi në hamam”. Amiri i shpjegoi ndryshimin e klimës midis dy vendeve. Ai ishte bërë një njohës i mirë i qytetërimit afrikan. I tha:

- Po i afrohem Dakarit, kryeqytetit. Këtu jemi në grykëderdhjen e lumit Senegal. Shikoje këtë bimësi dhe këto mrekulli të krijuara nga uji. Janë pemë ujore,

nuk japin fruta, janë vetëm pemë që kufizojnë lumin dhe i japin hije udhëtarit.

Karvanari ishte i lumtur që i kishte çuar deri atje dhe papritmas u bë fjalëshumë. Nuk pushonte së foluri për bukuritë e atij vendi, për dashamirësinë e popullsisë dhe sidomos për gatishmërinë e grave. Si udhërrëfyes, rrëfente historinë e këtij qyteti duke i mëshuar begatisë e tregtisë së arit dhe fildishit. Amiri ndërhyri për t'i kujtuar se kishte qenë edhe qyteti ku kërkoheshin skllevërit. Tjetri shtoi se atje ishte ngritur një aviator francez, me një avion të vogël, për të shkuar shumë larg! Karimi, i interesuar për historinë e këtij njeriu, pyeti se ku ishte ndërkohë dhe çfarë kishte bërë. I ati i premtoi se do të pyeste. Ndërkaq, ata vendosën t'i linin bagazhet përtokë dhe të laheshin. Jo shumë larg ishte një liqen i vogël, ku fëmijët laheshin duke bërë shumë zhurmë. Amiri mori abdesin, kërkoi drejtimin e Mekës dhe u lut, duke falënderuar Perëndinë që e kishte lejuar atë dhe djalin e tij të mbërrinin shëndoshë e mirë në atë vend magjik me ndërtesa të vjetra koloniale. Gjatë natës, karvanari zgjoi Karimin për t'i thënë:

- Mermoz është aviatori, emrin e kishte Mermoz, më kujtohet, shkoi në Merika, Lamerik...

Ata ndenjën dy ditë e dy net në Ndar dhe, herët në mëngjes, u nisën për në Dakar. Udhëtimi zgjati tërë ditën dhe një pjesë të natës. Amiri priti të zbardhte për të hyrë në Dakar, qytet që, me shëtitoret e drejta, me

ndërtesa moderne, i kujtonte Kazablankën. Karvanari ishte shumë i eksituar. Amiri e pagoi dhe i tha:

- Pas dy muajsh, përpiqu të na gjesh, nuk do të jemi larg shtëpisë së Mohës.

Moha ishte pronari i një hoteli të vogël, të quajtur *Miku i udhëtarëve*, ku Amirit i pëlqente të qëndronte para se të bënte hyrjen e tij “zyrtare” në qendër të Dakarit. Ata u lanë, hëngrën dhe pushuan pak. U pritën si princa. Pastaj Amiri u largua duke i thënë:

- Mos më prit për drekë, do të kujdeset Moha për ty.

Karimi doli për një shëtitje. Amiri nuk kishte pse t’i thoshte të tregohej i kujdesshëm. E dinte se djali i tij kishte një ndjenjë tepër të zhvilluar për t’u orientuar dhe se do të kthehej pa asnjë problem. Gjatë shëtitjes, Karimit iu krijua një përshtypje e çuditshme, por e këndshme: i dukej se atje ishte i sigurt, sikur të gjithë senegalezët ishin pjesëtarë të familjes së tij. Megjithatë, e kishte të vështirë të përshtatej me vapën e madhe dhe me atë diell të fortë. Kishte vapë, djersinte. U kthye në shtëpi dhe veshi një gandura të gjerë dhe të lehtë. Rrobat e tij europiane nuk përshtateshin me atë klimë.

Amiri, kur shkante në Senegal, e kishte bërë zakon të lidhte një “martesë për qejf” me Nabunë, një peule e bukur një metër e tetëdhjetë e gjatë. Ai kthehej çdo vit në të njëjtën kohë, linte plaçkat te

Moha, rinovonte kontratën martesore me Nabunë, vendosej në shtëpinë që kishte ndërtuar për atë, dhe jetonte si pasha, i kënaqur dhe i dashuruar. Për fat të mirë, ata nuk kishin bërë fëmijë. Për të, Nabuja ishte magjistare, pak fallxhore dhe kishte një bukuri dhe një sensualitet të paparë.

Gruaja e re e kishte braktisur kolegjin francez pasi kishte marrë dëftesën. Ishte krenare dhe në familje mbahej si dikush që “kishte dijet e të huajve”. Ndodhte shpesh që të bënte shkruetin publik: shkruante letra dashurie të grave të braktisura nga legjionarët si dhe ankesa drejtuar administratës koloniale.

Në krahët e saj, babai i Karimit e humbte toruan. Ajo i bënte akrobaci seksuale që e mbushnin dhe e zbraznin me energji. Sa herë që përfundonte lutjet e përditshme, ai ngrinte duart e bashkuara nga qielli dhe falënderonte Zotin që e kishte njohur me atë grua, e cila i jepte një kënaqësi, që nuk e kishte njohur kurrë më parë, dhe që nuk e gjente tek asnjë grua tjetër. Por nuk ishin vetëm këto çaste kënaqësie, Amirit nganjëherë i hipte delli nga romantizmi që e kishte mësuar nga poetët arabë dhe persianë dhe recitonte vargje me një ton pompoz. Kjo e bënte gruan për të qeshur. Ajo nuk thoshte asgjë, lëshohej e tëra dhe bënte gjithçka për ta kënaqur burrin e saj. Ata ishin të lumtur dhe Amiri nuk e kuptonte përse në Fes marrëdhëniet ishin të ndërlikuara.

Një vit, ai deshi ta merrte me vete për pelegrinazh në Mekë. Por, atë ditë, zbuloi se ajo nuk ishte

myslimane, se feja e saj nuk kishte të bënte me monoteizmin dhe se, në thelb, ajo nuk kërkonte asgjë. Kur donte të falej, ajo shkonte dhe e kalonte natën nën pemën më të vjetër, më të madhe dhe më të bukur, në dalje të qytetit. Ishte një pemë madhështore, të cilën askush nga ata që merrej me punët publike nuk kishte guxuar ta prekte. Madje, edhe francezët, që kishin drejtuar punimet për ndërtimin e rrugës, i kishin rënë qark. Nabuja i përkëdhelte lëvoren, i fliste dhe ndihej mirë, sepse ishte e bindur se të parët kishin lënë atje një pjesë të shpirtit të tyre. Ajo pemë ishte Zoti i saj, streha e saj, gjëja e shenjtë e saj. Ajo e quante “Haxhi Baba”. Hija e saj e qetësonte, prania imponante dhe mosha shumë e vjetër e saj i jepnin siguri. I pëlqente t’i rrëfehej asaj në vetmi kur dielli perëndonte, duke i lënë vendin një ajri të lagësht, të njomur në një legen të madh me pluhur ngjyrë gri, blu dhe argjendi. Për të, ky ishte çasti i duhur për të vendosur faqen te një degë dhe për t’i folur në ulufisht, në gjuhën amtare: “Këto ditë mendimet e mia kanë qenë të braktisura nga drita, kanë diçka prej muzgu, që nuk më pëlqen. Mbase kam bërë gabime, gabime ose thjesht jam treguar e pakujdesshme. Dje, shkela pa dashje një copë bukë. E mora, e putha, pastaj ua dhashë pulave, por nuk isha e kënaqur me veten. Një ditë tjetër, një ndjesi e çuditshme bëri që lotët të më derdheshin çurg, kur nuk kisha asnjë arsye pse të qaja. Ajo shoqërohej nga një muzikë çjerrëse që më kujtonte

zhurmën e pakëndshme të mprehësit të thikave kur kalon në rrugë. Pashë një karvan të gjatë që zbriste nga mali, i prirë nga një vel i madh i verdhë, që valëvitej fuqishëm në erë. Njerëz pa krahë, të tjerë pa këmbë, mbledheshin në hyrje të qytetit. Shikoja veten sikur të isha fëmijë që vraponte si gazelë, me lëkurën dhe sytë plot pluhur. Ishte një kohë kur gjithçka ishte e mundur. Të nesërmen në mëngjes, pashë gra të pikëlluara, me lot në sy. Askush nuk e dinte përse. Vështroja qiellin dhe nuk dalloja asgjë qetësuese. Më parë, kaltërsia e tij më krijonte dëshirën që të kërceja. Kohët e fundit, ngjyra blu është zhdukur dhe ja tek jam në gjunjë përpara teje, o Haxhi Baba. Mos i kam dëgjuar keq mesazhet e tua, fjalët e tua që sjell era? Mos kam humbur të gjithë besimin te shpirti im?

“Gjyshja më tregoi një zbulesë. Më tha se jam bërë me të njëjtin material si ëndrrat; sytë e mi tashmë janë gjetiu; më tha gjithashtu se ëndrrat nuk janë gjë tjetër veç mesazhe që vdekja na dërgon për ta pranuar ekzistencën e saj. Megjithatë, shpresa për të gjetur përsëri njeriun tim të bardhë, atë që më viziton një herë në vit, më shkund. Ai është njeri i mirë. Jepi atij fuqinë që të më bëjë të lumtur... Ai e di, e merr me mend se nuk jam grua besnike, se nuk mund të jesh e tillë kur ke lindur me një dëshirë më të fortë se arsyeja, këtu nuk ka asgjë të keqe, për këtë nuk flasim, ai e di, por nuk thotë asgjë. Në të vërtetë, unë nuk di asgjë.



“Në dimër, është kushëriri im Uad, që më ngroh kur kam ftohtë, ai e njeh mirë trupin dhe kërkesat e mia. Di t’i japë jetë dhe energji. Ne nuk flasim për këtë gjë. Mjafton që sytë të takohen dhe unë eci para dhe ai më ndjek pas. E di se çfarë do të më japë dhe çfarë do t’i bëj. Më pëlqejnë këto çaste, pikërisht para se të shtrihem në shtrat. Ëndërroj dhe në zemër e në trup ndiej gëzim. Ndonjëherë dridhem nga kënaqësia.

“Në pranverë, është Degoli, fqinji ynë, që mund të kishte qenë babai im, që më fton në shtëpinë e tij dhe më përkëdhel gjithë natën pa bërë asgjë tjetër. E lë, e pranoj që më pëlqen, që më qetëson, jam në krahët dhe në gojën e tij dhe, ndonjëherë, dremis nga përkëdheljet e tij aq të ëmbla. Ai është mjeshtër. Të nesërmen më dërgon shporta me fruta dhe perime, copa basmash dhe temjan, ndonjëherë mish të tharë. Për të ngrënë një muaj të tërë. Kur e ndien se ushqimet më kanë mbaruar, vjen e troket te dritarja ime.

“Ndodh gjithashtu që të epem para disa kërkesave të përsëritura të mjekut të ri francez, i cili thotë se ka rënë në dashuri me mua, gjë që më bën për të qeshur. Kur më avitet, i gjithë trupi i djersitet dhe bëhet flakë i kuq. Kjo më frikëson. Më thotë se e ka nga droja dhe faji. Një ditë i kërkova të më shpjegonte se çfarë ishte faji. Më tha se ishte i martuar me një grua të bardhë, e cila e priste në Dizhon, dhe se, kur vinte tek unë, ndihej sikur dikush e godiste me grushte në zemër, ndiente dhimbje, pastaj, ai dikushi niste ta qortonte.

Më kot i mbyllte veshët, dëgjonte që e shante, atëherë ulte kokën dhe i kërkonte ndjesë Kamilës që kishte qëndruar në Dizhon. Ky ishte faji. Unë nuk i njoh këto grushte dhe këto qortime. Unë i jap kënaqësi, ai më jep shumë ilaçe, që ua shpërndaj të afërmve të mi. Një ditë, më dhuroi një parfum parisian. Sa lyhem me të, ndihem si shitëse seksi, ka erë të çuditshme, mua më pëlqen era e qelbarit dhe e myshkut natyror, sapuni i zi dhe argjila, që m’i sjell Armiri nga Fesi.

“Ah, imzot, burri im, princi i vetëm që më mbush dhe më bën vërtet të bukur. Kur Armiri është këtu, unë jam e gjitha e tij; askush nuk guxon të më afrohet. Ngre flamurin maroken në çati dhe djeg temjan parajse. Të gjithë e dinë se im shoq ka ardhur. Disa fqinje vijnë dhe më urojnë lumturi dhe begati. Edhe pse janë ziliqare, nuk më lëndojnë. Përgatitem dy ditë radhazi për ta mirëpritur dhe për t’iu dhënë me mish dhe me shpirt. Ndryshoj sjellje, dua të them se ndihem tjetër femër, i përkas atij dhe më pëlqen të jem e tij, e gjitha e tij. Ndoshta kjo situatë nuk zgjat, ngaqë morali nuk e lejon. Sot ndodhem te këmbët e tua, e kapur pas rrënjëve të tua, o Haxhi Baba, jam e dobët dhe i nënshtrhem vullnetin tënd! Sa herë vjen, Amiri më çon te skribët në xhami, ata shkruajnë një kontratë martesore të përkohshme. Mendoj se kjo quhet “martesë për qejf”. Amiri do të jetë në rregull me fenë e tij. Unë nuk kam çfarë t’i them; ai më sajdis dhe unë kujdesem shumë për të.

“Një ditë, e pyeta: ‘Përse martesë jonë është martesë për qejf? Tjetra, ajo me gruan tuaj në Marok, çfarë martesë është?’ Ai më vështroi dhe më tha: ‘Atje është zakoni, këtu është liria!’.

“Nëna ime sillet keq me mua, ka nevojë për para, i jap kur kam, por ajo më thotë: ‘Është para e pistë’. Nuk e di se çfarë duhet të bëj për ta qetësuar. Ajo nuk e ka duruar kurrë që unë të dal duarsh dhe që burrat të bien në krahët e mi... Unë nuk bëj asgjë të keqe!”.

Atë vit, Nabuja nuk ishte e qetë. Përveç zilisë gjithnjë e më të dhunshme të fqinjëve, disa shpirtra e kishin bindur se do të vdiste në rrethana të paparashikuara për shkak të pabesisë ndaj Amirit. Do të hidhej nga ndonjë shkëmb, do ta pickonte ndonjë nepërkë me fytyrë njerëzore, do ta shtypte ndonjë elefant në kulmin e çmendurisë, do ta varnin në fund të një pusi, do ta mbysnin me një thes apo qese plastike, do ta helmonte fqinja? Apo do të ishte thjesht viktimë e një pushimi zemre në gjumë ndërkohë që në ëndërr shihte princin e saj arab? E bindi veten se do të vdiste e mbytur. Hidhte sytë rreth e qark, por nuk kishte as liqen, as det; të paktën atje ku ndodhej nuk i shihte. Mendonte se shpirtrat ishin gabuar, se do të bënin mirë ta linin në paqe dhe të shkonin gjetiu.

Kur pyeti një natë baobabin e saj, ky nuk reagoi. Ishte memec, i pandjeshëm, sikur nuk ekzistonte. Me gishtërinj shqeu një copë lëkure dhe nisi ta përtypë.

Ajo ishte aq e hidhur, sa e nxori sakaq nga goja dhe u largua. U kthye përsëri, ra në gjunjë dhe kërkoi ndjesë. Një degë u përkul mbi të dhe i përkëdheli supet. Kjo nuk e qetësoi. E tmerruar, ndjeu se zjarrmia po rritej. Vallë kishte ardhur ora? Megjithatë, ajo ishte ende e re dhe e fuqishme. Po djersinte shumë dhe pa në qiell yje të zjarrta, shenjë se e kishte zënë mallkimi. Asgjë nuk ishte më në vendin e vet. Papritmas, u ndie jashtëzakonisht e vetmuar dhe nxori nga xhepi një pasqyrë të vogël, ku pa veten. Ishte tepër e frikësuar. Ajo që i qëndronte përballë ishte e rrudhur, e plakur dhe e keqe, kishte sy të zverdhur, jargë në cepa të buzëve. Ktheu kokën nga komshija e saj, nënë e tetë fëmijëve, pa bashkëshort, pa ndihmë. Nabuja e dinte se ajo grua ishte e brerë nga zilia dhe marrëzia. Ndoshta kishte arritur t'i bënte magji, sidomos ngaqë Dia i famshëm, magjistari më i madh në vend, sapo ishte larguar nga qyteti pasi i kishte shërbyer një njeriu shumë të pasur që kishte humbur fuqinë seksuale. Dias i kishte dalë nami se e shkrinte hekurin vetëm duke i ngulur sytë. Ai dinte të shëronte shpirtrat e trazuar dhe të largonte të keqen nga trupat e kërcënuar nga sëmundja. Ai gjithashtu mund të trazonte shpirtrat dhe ta bënte gjumin të pamundur. Thuhej se një udhëheqës ishte çmendur dhe ishte hedhur nga maja e një shkëmbi.

Për herë të parë, Nabuja, që nuk e kishte njohur kurrë këtë ndjesi, ishte e frikësuar. Ajo zbuloi panikun që përmbys gjithçka, derdh baltë në ujë të pastër,

shkul rrënjët dhe e ngjyen botën me gri dhe me të zezë. Frika e brente, e ndiente trupin të shkundur, të shqetësuar, të dhunuar. Mendonte: “Unë jam si një peshqir i shtrydhur nga fati; nuk është ujë, janë pika gjaku, është gjaku im, gjaku që duhet të humbas, sepse jam e dënuar, ndërkohë që nuk kam bërë asgjë të keqe, të paktën, asgjë vërtet të keqe. Parandjenja ngul këmbë. Çfarë duhet të bëj? Me kë duhet të flas? Jam vetëm dhe përpëlitëm në një pyll të zi me hije të këqija, që duan të më çmendin. Beto hem se do t’i përkushtohem vetëm burrit tim, burrit tim të vetëm, Sidi Amirit, njeriut më bujar nga të gjithë njerëzit”.

Pak ditë para se të mbërrinte Amiri, asaj i shkoi në mendje të vizitonte Mohan, plakun e urtë të Ties, një qytet i vogël në lindje të Dakarit. Mohanin, njeriun më të çmendur dhe njëherësh më njerëzor të vëllazërisë Tijane. Ai shkëmbente letra me sufistët e Fesit, të cilët pjesën më të madhe të kohës e kalonin duke studiuar tekstet e shenjta. Fjalët e tij ishin të njohura për aftësinë e tyre qetësuese, për rikthimin e shpresës dhe të durimit. Ai thoshte gjithçka që mendonte; nuk kishte çfarë të humbiste; për të edhe jeta nuk kishte rëndësi. Jetonte brenda një baobabi të vjetër, të tharë prej kohësh, që nuk kishte asnjë fuqi. Kishte hapur atje një zgavër, ku jetonte vetëm. Herë pas here, një qen bredhacak gjente atje strehë. Me të ndante atë pak ushqim që kishte dhe e linte të largohej. Nabuja

nuk mund të shkonte duarbosh. I shpuri një vazo me mjaltë dhe ullinj që ia kishte sjellë Amiri nga Fesi në qëndrimin e të tij të fundit.

Moha i kujtoi se problemet që kishte mund të shkatoheshin ngaqë ishte e bukur. Zilia ishte një merimangë që e thurte pezhishkën rreth shpirtit të saj. Duhej prishur ai mallkim që ajo të jetonte në paqe. Ajo i tha se do të dëshironte shumë që një ditë Amiri t'i propozonte që ta merrte me vete në Fes. Moha u ngërdhesh. E njihte mirë atë qytet dhe banorët e tij:

“Ata janë njerëz të qytetëruar, por ndihen më superiorë ndaj nesh, gjithsesi, janë të bindur se i ka zgjedhur Perëndia. Janë myslimanë të mirë, njerëz të mirë, por duan të skllavërojnë dhe të dominojnë. Ju jeni e zezë, unë jam metis, nuk e kemi vendin në zemrat e tyre, në qytetin e tyre. Por ku i dihet? Mund të biesh në një familje bujare, që respekton njerëzimin. Po ike, duhet të marrësh disa masa mbrojtëse. Unë nuk jam magjistar, por kam nuska, ku kam shkruar me dorën time vargje nga *Kurani*. Po pate besim, ato do të të mbrojnë, përndryshe, duhet të përballesh vetë me problemet e vështira. Po deshe, i dërgoj një letër Si Mostafës, një burri me të cilin shkëmbej letra dhe që është imam në Xhaminë e Madhe dhe në universitetin e qytetit të vjetër”.

Nabuja i kujtoi atij se nuk ishte myslimane.

“Ky është çasti që ta përqafosh këtë fe, e cila, kur kuptohet mirë, mund të jetë një ndihmë e madhe.

Njerëzit gjithmonë kanë nevojë t'i qetësojnë ankthet e tyre. Mendoj se i krijuan fetë për të përballuar jetën dhe misteret e saj, ngaqë vdekja është enigma kryesore që askush nuk e ka zgjidhur. Unë besoj te të gjithë profetët. Njoh disa tekste që i kam mësuar përmendësh dhe mund të të them se Islami, Katolicizmi ose Judaizmi, janë fe të ngjashme. Misioni i tyre është të qetësojnë njeriun dhe ta paralajmërojnë kur i kalon kufijtë; kjo është arsyeja pse ekziston ferri dhe parajsa.”

Ajo e pyeti si mund të bëhej myslimane. Moha e këshilloi të fliste me burrin e saj. Ai ishte njeriu i duhur për ta futur atë në fenë e Muhamedit. Moha i tha ta falënderonte Amirin, sepse mjalti dhe ulla e Fesit ishin të jashtëzakonshëm. Ajo u largua e qetësuar, e vendosur për t'u bërë myslimane.

Gjatë kthimit, ajo u ndal para baobabit të saj, ia nguli sytë sikur të merrte lejen, bekimin, mbështetjen e tij. Ishte e lumtur për këtë nismë, që, sipas saj, do ta çlironte nga frika, nga syri i keq i grave ziliqare. Ajo tha: “Allahu është i madh, nuk kam frikë”. Kur u kthye në shtëpi, u lut në heshtje dhe kërkoi falje për mëkatet e shumta që kishte bërë. Me zemër vendosi që nuk do ta prekte më kurrë askush tjetër përveç Amirit. U la duke fërkuar fort lëkurën sikur të fshinte kujtimet e akteve seksuale që kishte pasur me burra të tjerë. U fërkua derisa i dhëmbi lëkura. I duhej një lëkurë e re për t'u bërë zonja e denjë e një Amiri,

një burri hyjnor, njeriu të mirë dhe bujar. I foli trupit sikur të ishte njeri : “Tani do të qëndrosh urtë, nuk ka akrobaci, vese, sigurisht që do të japësh kënaqësi, por pa çmenduri!”. Pa mbaruar mirë këto qortime, ndjeu brenda vetes të ngrihej një dëshirë edhe më fortë se zakonisht. Qeshi dhe doli te pragu i portës.

Nabuja ndjeu në flokë një flad të freskët. Ktheu kokën dhe pa Amirin, të veshur me të bardha, që i zgjaste krahët. Nuk kishte më frikë, nuk kishte më turbullim. Nxitoi drejt tij, mbështeti kokën te gropa e qafës së tij dhe u fërkua me të. Ndjeu organin e tij të bëhej dru. E parapriu dhe i kërkoi të bashkohej me të menjëherë pasi të bënte banjë. Donte t’i epej plotësisht burrit të saj, pa asnjë rezervë apo tabu, sikur të ishte nata e fundit. Lëkura i ndriste nën dritën e hënës. Ishte parfumuar me esencën e një luleje të rrallë që e quante “Dëshirë”. Lakuriq, nën çarçaf, priste të zotin. Në horizont nuk kishte më stuhi, nuk kishte më re. Ishte e qetë dhe njëherësh e ephsme. Trupi i saj tashmë përshkohej prej drithërimash nga ideja e kënaqësisë që do të jepte dhe do të merrte. Ato ngriheshin nga gishtat e këmbës deri te rrënjët e flokëve. Ndihej mirë, e sigurt, e gatshme për të ndarë gjithçka. Amiri, që sapo kishte mbushur të pesëdhjetat, ishte i pushtuar nga një dëshirë jashtëzakonisht e fuqishme. Edhe ai kishte përshtypjen se kjo natë nuk do të ishte si të tjerat, se do të ishte një natë fatale, e



bukur, enigmatike, sensuale, e çmendur, ndoshta nata e fundit. Për një çast, u frikësua, pastaj, e përzuri këtë ide me shpinën e dorës dhe ia nguli sytë vitheve të mrekullueshme që ngriheshin para tij e që nxirrnin në pah vulvën e kuqe me disa qime të ashpra përreth si rojat e një virtyti të pamundur. U befasua që iu ngrit, sepse, gjatë gjithë jetës, kurrë nuk kishte ndier një dëshirë aq të fortë sa atë ditë përballë trupit të Nabusë. Ajo nuk fliste, por trupi i saj lëvizte në mënyrë të atillë që kërkonte përkëdhelje, që Amiri nxitonte t'ia plotësonte për ta kënaqur. Asnjë lëvizje nuk ishte e rastësishme apo e pakëndshme. Nabuja printe vallen me lehtësi të paparë, duke dhënë kënaqësi të pafund dhe duke marrë po aq, madje edhe më shumë. Më pas, vazhduan më ngadalë për ta zgjatur dashurinë, duke e shtyrë çastin e rëndësishëm të orgazmës. Nabuja u lag disa herë, por nuk tregoi me qëllim që burri i saj të vazhdonte sa më gjatë pa u prishur. Për të mos u prishur, ai mendonte gruan e bardhë që i jepte aq pak kënaqësi. Fakti që sillte në mendje imazhin e saj e qetësonte pak sekonda dhe pastaj riniste më fuqishëm me ekstazën që ajo krijesë e bukur shkaktonte brenda tij aq lehtë. Ai e merrte atë në pozicione që i shpikte vetë. Trupi i Nabusë, me një lakueshmëri të mrekullueshme, epej me forcë dhe elegancë ndaj fantazive të Amirit. Dukej sikur një qenie e padukshme u diktonte atyre çfarë të bënin dhe u thoshte se po përjetonin një përvojë që nuk do ta rijetonin kurrë më. Zëri thoshte: “Është

nata juaj e vetme, e pakthyeshme. Një natë e dhënë bujarisht nga vdekja, që kujdeset që kënaqësia juaj të shumëfishohet derisa të mbërrijë në majën e malit më të lartë. Atje ku shenjtorët dhe të çmendurit mblidhen tok për të thënë poezinë më të pastër, më të sqimët, më të fuqishme - të pathënë, të pamundur, fillimin e udhëtimit të fundit, ndoshta më të mrekullueshmin apo më të tmerrshmin”.

I zuri gjumi të përqafuar si fëmijë. Ishte një lodhje e bukur, ajo e një nate të paharrueshme. Në mëngjes, Nabuja doli për të blerë fruta, bukë dhe përgatiti mëngjesin. Fuste një gisht në vazon me mjaltë dhe e shpinte atë te goja e burrit të saj. E ushqente me përkushtim të veçantë, duke i puthur disa herë dorën. Nuk hante, thoshte se nuk kishte uri. Pastaj, doli lakuriq në oborr dhe u la me kova të mëdha me ujë, që i derdhte mbi trup, duke kënduar. Fqinja e këqyrte pa folur, por në sytë e saj ishte mbledhur gjithë zilia e botës. Nabuja nuk e çante kokën. Ndihej e fortë. Nuk kishte frikë nga asgjë. U afrua te burri i saj dhe i tha me zë të çuditshëm dhe të butë:

- Ju e dini, nuk jam si shumica e grave senegaleze, ndihem plotësisht e lirë në mendimet dhe veprimet e mia. Babai im ishte mysliman, i lindur në qytetin Ziguinshor në Kazamanka, nga fisi diolas. Ishte bashkuar me ushtrinë franceze. Në atë kohë, më rrëfente xhaxhai im i moshuar, Franca kishte premtuar se do t'i jepte pavarësi këtij vendi, por nuk e bëri.

Babai vdiq për Francën. Nga ana e nënës, jam peule, por e shkreta ishte e rrëguar, e dërrmuar nga sprovat e jetës dhe nga shtatzënitë e shumta. Ndërsa unë jam këtu në duart tuaja, e gatshme t'ju ndjek pas deri në fund të botës!

Ajo zgjodhi këtë çast, pas banjës, për t'i kërkuar Amirit që ta konvertonte në Islam. I habitur, por i lumtur, ai i kapi duart, ia puthi, pastaj nisi të recitonte vargjet e Fatihës, suren e parë të *Kuranit*. Pastaj i përmendi pesë shtyllat e Islamit, duke ia shpjeguar. I kërkoi të përsëriste pas tij fjalët e Shahadës: “Dëshmoj se ka vetëm një Zot dhe Muhamedi është profeti i tij”.

Amiri pastaj i sqaroi asaj vlerat e kësaj feje:

- Nuk duhet të besosh se ka shumë Zota; Perëndia është një, i fuqishëm dhe i mëshirshëm. Për të qenë mysliman i mirë, mjafton të besosh në këtë Perëndi të vetëm dhe te Muhamedi, i dërguari i tij; nuk duhet të vrasësh, të vjedhësh, të gënjesh, të tradhtosh, të bësh keq, të besosh te Satanai dhe te shërbëtorët e tij; duhet të ndihmosh të varfrit; të japësh lëmoshë, të lutesh, të bësh pelegrinazh në Mekë kur ke mundësitë materiale dhe shpirtërore. Me pak fjalë, duhet të jesh e mirë dhe nuk duhet të bësh kurrë keq. Kjo është një luftë e përhershme kundër tundimeve.

Ajo e uli kokën dhe pëshpëriti:

- Ky nuk është Islami që njoh unë. E di se gruaja nuk është e barabartë me burrin dhe se, për shembull,

trashëgon vetëm një pjesë të vogël, ndërsa burri ka pjesën...

- Dëgjo, Nabu, mos e ngatërro Islamin me myslimanët. E rëndësishme është të kemi një sjellje korrekte dhe njerëzore. Cilido që keqtrajton një grua nuk ka nevojë ta bëjë në emrin e fesë. Por unë e di se disa i përlligjin veprimet e tyre të këqija, duke iu referuar Islamit. Ata e kanë gabim. Gjithçka që mund të them është se unë të premtoj se do të të dua dhe do të të jap më të mirën që kam. Sa i përket trashëgimisë, pabarazia është e vërtetë, ajo vjen që nga koha kur gruaja nuk punonte.

Nabuja e kundërshtoi:

- Po Kadija? A nuk ishte Muhamedi në shërbimin e saj para se të martohet me të?

Amiri buzëqeshi:

- Duket që je e mirinformuar.

E mallëngjyer, Nabuja vuri gishtin te goja e të shoqit dhe të dy ranë në ëndërrime romantike.

Amiri, i lumtur, i mbushur nga kjo grua kaq e re, kaq e zgjuar, kaq e bukur, mendoi se me Lalla Fatmën nuk e kishte provuar këtë ndjenjë. Martesa e tyre ishte bërë sipas rregullave të traditës. Ata nuk e kishin zgjedhur njëri-tjetrin por, pavarësisht kësaj, duhet ta donin njëri-tjetrin, domethënë, të bënin atë që familja priste prej tyre: fëmijë. Amiri nuk e kishte shkelur këtë rregull, gruaja e tij kishte rënë shtatzënë në tremujorin e parë të bashkimit të tyre. A kishte

dashuri mes tyre? Kjo pyetje nuk shtrrohej. Faqja ruhej. Tregtia e Amirit ecte mirë dhe Lalla Fatma mbretëronte si zonjë e padiskutueshme në shtëpi dhe në edukimin e fëmijëve. Nuk humbisnin asnjë festë, asnjë ftesë familjare. Tradita respektohej në mënyrë të përkryer. Asgjë nuk binte ndesh me këtë organizim të vendosur prej shekujsh. Në qytetin e Fesit, të mbyllur në vetvete, vorbë e civilizimit arabo-andaluzian, nuk bëhej shaka me zakonet. Amiri ishte bashkëshorti i Lalla Fatmës. Lalla Fatma ishte gruaja e tij. Kjo lidhje nuk vihej në diskutim. Prova: ata nuk ishin grindur kurrë. Por kjo harmoni e qetë, ky ritual i njëjtë deri në vdekje, vallë dashuri ishte? Askush nuk do të kishte guxuar ta prishte këtë rend stërgjyshor. Sa për dashurinë, atë e shikonin te filmat egjiptianë plot me klishe...

Për herë të parë, Amiri mendoi se kishte një mënyrë tjetër për të jetuar, vuri re se ndjenjat që kishte ndaj Lalla Fatmës ishin tepër të ndryshme nga ato që provonte në krahët e Nabusë. Jeta iu duk befas e përmbysur. Vendosi të mos i frenonte hovet dhe pasionin. Miqtë e tij të *Divanit* do të ishin tallur po t'u kishte folur për këtë ndjesi që provonte për herë të parë. Ai nuk i kishte thënë kurrë “të dua” ndonjë gruaje, nuk kishte dhuruar lule, nuk i kishte shprehur kurrë ndjenjat. Kështu e kërkonte edukimi i ngurtë. Dobësitë nuk shfaqeshin para një gruaje. Të qenët i dashuruar gjykohej si dobësi, anomali.

Koha kalonte, Amiri e ndiente zemrën gjithnjë e më të lehtë pranë Nabusë. Por tregtinë nisi ta linte pas dore. Ishin tregtarët që shkuan dhe i kujtuan se mallrat nuk ishin gati dhe se duhet të bënte porosi që ata t'i sillnin nga Kameruni dhe herë-herë nga India. Ai i falënderoi për shqetësimin dhe u tha: “Bëni si zakonisht: qimnon, koriandër, xhinxhimbër, kurkuma, piper të kuq, përzierje erëzash me mizat e tyre, piper, kanellë, karafil, kardamonë, mbi të gjitha jo kerri, banorët e Fesit nuk e pëlqejnë këtë erëz, dhe, po gjetët shafnan, hiqeni mënjanë, do ta marr me vete në një kuti të mbyllur hermetikisht... Sasinë e dini vetë, kam besim te ju!”

Nabuja i tha me butësi se do të ishte më mirë të vazhdonte të kujdesej vetë për porositë. Ajo nuk u besonte atyre njerëzve, thoshte se dashamirësia e madhe merrej si shenjë dobësie dhe se kishte rrezik që ata ta vidhnin. Mes tyre nisi një diskutim. Ajo i tha se e kishte gabim që nuk dyshonte tek ata tregtarë dhe se ishte naivitet të besojë se afrikanët ishin të gjithë të mirë dhe të ndershëm:

- Ata janë si të gjithë të tjerët; mes tyre ka njerëz korrektë, por ka edhe shumë të pandershëm; është në interesin tuaj t'i kontrolloni mallrat kur i merrni në dorëzim.

Amiri e mori këtë mësim si provë dashurie. E shtrëngoi në krahë Nabunë dhe e uthi, duke i thënë:

- Faleminderit, Nabu, faleminderit për këtë këshillë!

Pas disa ditësh intimiteti, Amiri thirri të birin dhe e prezantoi me Nabunë. Që të dy dukeshin të frikësuar. Shtëpia që kishte ndërtuar Amiri ishte mjaft e madhe që Karimi të qëndronte me ta.

Karimi bëri vetëm një reagim. Hapi krahët dhe tha:  
- Mirë se vini... në... në familje!

Disa ditë më vonë, kur burri i saj i përkohshëm i propozoi ta merrte me vete në ishullin e Goresë, ku do të takonte një furnizues dhe do t'i bënte vizitë një plaku të urtë, ajo nuk pranoi ta ndiqte pas. Ishte hera e parë që guxonte të mos i bindej të shoqit. Ai e pa me dhembshuri dhe e kuptoi se ajo nuk ndihej mirë. Vendosi dorën mbi supin e saj të zhveshur dhe i kërkoi që t'i tregonte se çfarë kishte. Pasi heshti një hop, ajo shpërtheu në lot:

- Po erdha me ju, më pret vdekja; jam aq e sigurt, sa nuk më zë gjumi. Paraardhësit e mi nuk rreshtin së përsërituri që të mos shkoj në Gore, sepse shpirti i stërgjyshit tim është i burgosur në ishull, në një pus, ku e kanë hedhur tregtarët e skllevërve. Mund ta liroj vetëm duke qëndruar pranë pemës sime. Duhet të flas dhe të flas derisa ta ndiej shpirtin e tij të lirë të fluturojë në qiell. Për sa kohë që nuk do ta vendos këtë drejtësi, stërgjyshi im do të vuajë përsëri dhe përsëri.

Amiri nuk këmbënguli, i kërkoi që ta priste. Mendoi se ajo nuk e kishte kuptuar ende frymën e fesë myslimane, por e respektoi frikën dhe dëshirën

e saj për të liruar shpirtin e një paraardhësi. Karimi, i cili kishte marrë pjesë në atë skenë, ishte i magjepsur nga forca e bindjes së Nabusë. Ai zbuloi në të njëjtën kohë një univers besimesh larg besimit të tij. Amiri u nis me të birin për në Gore. Kur mbërriti në ishull, ku i ati duhet ta prezantonte me Haxhi Mabrukun, plakun e urtë shëronjës, Karimit në fillim i bëri përshtypje bimësia e harlisur. Ai nuk ua dinte emrat shumicës së bimëve që e rrethonin. Amiri i tregoi një rresht të tërë bugebvilesh, që ishin aq të bukura sa ato në të dalë të Fesit. Ndërsa palmat ishin më të ulëta se ato të Marrakeshit, por më të dendura. Baobabët, që ai i kishte zbuluar në Dakar, atje kishin një pamje të veçantë. Trungjet e tyre aq të gjera dhe masive dhe degët e tyre, që formonin flokate të imëta mbi një kurorë të madhe, u jepnin disa pemëve pamjen e statujave të gdhendura nga natyra. Amiri i tha: “Këto pemë janë disa qindravjeçare dhe afrikanët i quajnë pemë magjike, objekte të shenjta që ruajnë kujtimin e të parëve. Për disa, kjo është pema e jetës, për të tjerët, objekti i të gjitha origjinave ku qëndron çelësi i të gjitha mistereve”. Ai ishte i mrekulluar. Pyeti të atin përse marokenët nuk ndiheshin si afrikanë dhe nuk besonin në këtë magji.

Amiri i shpjegoi se ai ishull, që kishte kaluar nga duart e holandezëve në duart e francezëve dhe të anglezëve, ishte vendi nga ku sklleverit niseshin për në Amerikë. Disa vinin nga qyteti Sen-Lui i Senegalit,



të tjerë nga Gana. Kishte ende disa gjurmë të kësaj tragjedie, që vizitori mund t'i merrte me mend. Karimi nuk e kuptonte përse u bëhej keq njerëzve të pafajshëm. Amiri përpiquej ta qetësonte dhe i thoshte se, si mysliman i mirë që ishte, e dënonte skllavërinë.

- Ti e di, një plak i urtë thoshte se duhet falënderuar Perëndia për shpikjen e kalit, përndryshe, të bardhët do të kishin përdorur zezakët për shalë. Njeriu gjithmonë ka dashur t'i poshtërojë të tjerët, sidomos të varfrit, njerëzit me ngjyrë, njerëzit e pambrojtur. Kështu është. Skllavëria ka qenë një tmerr dhe vazhdon ende në disa vende, jo zyrtarisht, por e maskuar. Marokenët nuk ndihen afrikanë sepse kanë lëkurë të bardhë.

- Të jesh afri... afrikan, duhet të... duhet të kesh lëkurë të zezë?

- Jo, ne jemi, ti dhe unë, e gjithë familja jonë, afrikanë.

- Si... si Na... Nabuja?

- Po, pothuajse, biri im!

Haxhi Mabruku i priti duke recituar lutje dhe duke djegur temjan parajse në një shandan të vogël argjendi. E mori Karimin në krahë, e përqafoi, pastaj, pas disa lutjeve të heshtura, tha:

- Ky fëmijë është dhuratë e Perëndisë, dritë. Jeni me fat që e keni. Ai është kuptimi i jetës dhe hiri i dashurisë. Rrallëherë kam takuar një pastërti të tillë në një mendje dhe në një trup. Ky fëmijë nuk është me të meta. E di, ka vështirësi në të folur dhe gjithmonë do

ta ketë të vështirë që të shprehet me fjalë, por zotëron gjëra më tepër se fjalët, ka një zemër të madhe, të mirë, dhe sheh më mirë se kushdo tjetër. Po, Karimi sheh me sytë e tij, por edhe me zemrën e tij. Nuk do të bëjë kurrë keq. Por ju duhet të kujdeseni për të, ta mbron, të mos lejoni njerëzit e këqij t’i afrohen. Gjithsesi, ai do t’i dallojë ata para jush. Kini besim tek ai. Nuk do të bëjë studime të mëdha, por më mirë kështu; ai do të jetë njeriu i mirësisë së bukur dhe të epërme. Diturinë e ka marrë që në lindje. Ia ka dhënë Perëndia, sepse nuk është i armatosur për të mësuar gjithçka si fëmijët e tjerë. Te ne, këta fëmijë kërkohen pasi i konsiderojmë si lajmëtarë të Perëndisë. Të tjerë janë ata që vihen në provë: ju, prindërit, si dhe të gjithë ata që jetojnë pranë tij. Sot, ma besoni mua Karimin. Do të jeni i qetë gjatë takimeve dhe unë do të dëshiroja shumë të flisja pak me të për jetën dhe të gjitha misteret e universit. Kthehuni në darkë. Do t’ju pres.

Në darkë, Amiri e gjeti djalin të veshur me një gandura të bukur, që ia kishte dhënë Shadja, një nga vajzat e plakut të urtë. Ai ishte i lumtur dhe dukej i qetë. Kishte ngrënë shumë dhe nuk i ndalonte dot gromësimat e pasuara nga “Hamdululah” sikur të kërkonte falje. Gjatë ditës, kishte mësuar shumë, por gjithashtu i kishte mësuar shumë gjëra plakut. Buzëqeshja e tij ishte e mrekullueshme. Amiri falënderoi përsëri Zotin që i kishte dhënë atë fëmijë, të cilin nganjëherë e quante “engjëlli im”.